

VENDIM
Nr. 92, datë 13.5.2024

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR
APLIKIMIN E SHOQËRISË “5GX ENERGY” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/3 prot., datë 10.5.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë ‘5GX Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “5GX Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 867 prot., datë 3.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 64, datë 12.4.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.4.2024 dhe 15.4.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 22.4.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 867/3 prot., datë 22.4.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 867/4 prot., datë 30.4.2024 dhe shkresën me nr. 867/5 prot., datë 3.5.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit. Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, rezulton se nevojitet të depozitohet dhe sa vijon:

- *dokumentacionin mbështetës financiar për të garantuar ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 1.3, gjerat “b” dhe “c”).*

- Në nenin 14, pika 3 të rregullores parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*

- Me qëllim që t’i lihet kohë shoqërisë për të depozituar qëndrimin apo miratimin përkatës të MIE-s për ndryshimin e vlerës së investimit dhe dokumentacionin përkatës për disponimin e shumës së mbetur të vlerës së investimit, si dhe të bëjë me dije datën e fillimit të punimeve në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e këtij vendimi, shoqëria të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “5GX Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti